



Republika e Kosovës - Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica - Municipality of Gjakova



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. 352/01-274/2018
Dt.26.09.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 85/2010), nenit 12 dhe 17 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 1, pika (p), Neni 17 pika ”b”, Neni 55, pika “m” të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe kërkesës nr.ref. 120/IKMN/2018, të datës 22.01.2018 nga Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.09.2018 pas diskutimit në pikën e 7 të rendit të ditës të Ndryshme, lidhur me rekomandimin e MAPL-së dhe MMPH-së për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimeve për shpalljen nën mbrojtje si monumete të natyrës nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS SHPELLA E KUSARIT I DHE II NË KUSAR
TË GJAKOVËS SI MONUMENT I NATYRËS

Neni 1

Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës SHPELLA E KUSARIT I DHE II në fshatin Kusar të Gjakovës, monument i natyrës i karakterit speleologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës). Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike speleologjike, vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Gjakovës dhe përfshin sipërfaqe të mbrojtur prej 5 ha.

Neni 2

Monumenti i Natyrës Shpella e Kusarit I dhe II në fshatin Kusar shtrihen në territorin e dy parcelave kadastrale: në parcelën 01734-0 dhe 01977-0, zona kadastrale Pjetërshan, nr. P-70705057-01934-0 dhe P-70705057-01977-0, me sipërfaqe 315198 m² dhe 578321 m², e regjistruar si pronë shoqërore e PSH Ekonomija Pyjore (Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, K. K. Gjakovë).

Neni 3

Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

Neni 4

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

Në Monumentin e Natyrës ndalohe:

- a) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur
- b) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur
- c) Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- d) Prerja e pyjeve, nderzja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme,
- e) Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,

- f) Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
- g) Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- h) Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

Në Monumentin e Natyrës lejohen:

- a) Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

Neni 5

Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

- a) Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
- b) Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
- c) Ndërrimi i kulturës,
- d) Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

Neni 6

Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Gjakovës.

Kujdestari është i detyruar:

- a) Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
- b) Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund të shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- c) Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Neni 7

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Neni 9

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetari të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,
Z. Anton Shala

